

VENDIM
Nr. 34, datë 23.11. 2015

PËR TARIFËN E SHITJES SË UJIT ME SHUMICË PËR SHA UK SARANDË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos i miratojë sh.a. UK Sarandë tarifën e shitjes së ujit me shumicë për fshatin Vrion të Bashkisë Finiq.
 2. Sh.a. UK Sarandë do të vazhdojë të furnizojë më ujë fshatin Vrion deri në përfundim të procedurave që lidhen me ristrukturimin e shërbimit të furnizimit me ujë për Bashkinë Finiq.
 3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Tekniko-Ekonomike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi